

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PS përshpejton procedurat për Hartën e re Territoriale, synon ta miratojë më 8 tetor
ADRESA	https://versus.al/politike/ps-pershpejton-procedurat-per-harten-e-re-territoriale-synon-ta-miratoj-i46820
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 15:56:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:51:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	60d0a93242a320eba2ee6cbe62bcb6828e103a049ef8bd7460ee96f310e2e1a8
TEKSTI	e5a407bf494179b918511f9959c3fa26498dcb31b07a48973ee468121e90e714
PAMJA	5b5b42edfac9021c799f7c14e67f7dceef1fb8d65380ad9577646603cd8fd55e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e23d2851a4c08feeeb2c47fd1c5da0cfbdea7a067762bf48921ecca51d4054d2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c772b20bb2a9907638c08fb1d7825d304059f9fa1ba842ea47b37301891e0c1b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e23d2851a4c08feeeb2c47fd1c5da0cfbdea7a067762bf48921ecca51d4054d2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Krim i rëndë në Tiranë, i moshuari vret me thikë gruan! 68-vjeçari: Kishim konflikte herë pas here](#)

19 Shtator 2026, 12:55

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[POLITIKË](#) / 19 Shtator 2026, 17:51

PS përshpejton procedurat për Hartën e re Territoriale, synon ta miratojë më 8 tetor



Shkruar nga Versus





Partia Socialiste pritet të përshpejtojë procedurat parlamentare për miratimin e Reformës së re Administrative Territoriale, pavarësisht kundërshtive që propozimi ka shkaktuar edhe në nivel vendor. Procesi nis të hënën në Konferencën e Kryetarëve dhe vijon në Komisionin e Ligjeve, ku do të miratohet kalendari i punës. Sipas burimeve, synimi është që propozimi të votohet në seancën plenare të 8 tetorit, ndërsa data 15 tetor konsiderohet afati maksimal për përfundimin e procedurës, për shkak të afateve që lidhen me përgatitjen e zgjedhjeve vendore.

Diskutimet parlamentare parashikohet të zgjasin vetëm dy javë. Më 23 shtator do të prezantohet në parim ndarja e re e propozuar nga socialistët, e cila parashikon reduktimin e numrit të bashkive nga 61 në 46.

Më 28 shtator pritet të zhvillohen brenda një dite seancat dëgjimore me përfaqësues të Këshillit të Ministrave, Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, Shoqatës së të Zgjedhurve Vendorë dhe ekspertë të qeverisjes vendore.

Më pas, një javë do t'i kushtohet shqyrtimit nen për nen, ndërsa miratimi në tërësi nga Komisioni i Ligjeve parashikohet më 5 tetor. Projektligji pritet t'i kalojë seancës plenare më 8 tetor, ku shumicës socialiste do t'i duhen 84 vota. Pas votimit në Kuvend, ligji do t'i dërgohet Presidentit për shqyrtim dhe dekretim.

Propozimi parashikon shkrirjen e 15 bashkive dhe bashkimin e tyre me njësi fqinje. Bashkitë që pritet të humbasin statusin si njësi të pavarura janë Fushë-Arrëzi, Klosi, Rrogozhina, Dimali, Poliçani, Patosi, Divjaka, Selenica, Maliqi, Këlcyra, Memaliaj, Libohova, Cërriku, Belshi dhe Përrenjasi.

Këshilltarë të majtë dhe të djathtë në disa prej këtyre bashkive kanë kundërshtuar propozimin, por qëndrimet e tyre nuk e kanë ndalur vijimin e procedurës.

Nëse miratohet, kjo do të jetë reforma e dytë territoriale e ndërmarrë nga socialistët gjatë qeverisjes së Edi Ramës, pas ndarjes së vitit 2014. Edhe këtë herë palët mbeten pa konsensus: opozita kërkon rreth 100 njësi vendore, ndërsa propozimi i PS-së parashikon vetëm 46 bashki./Versus.al

Tags:

[partia socialist](#)

Poll



POLITIKË

[Rama udhëton sot drejt SHBA, merr pjesë në mbledhjen e Asamblesë së OKB](#)

19 Shtator 2026, 13:32

^ekstrakti^





POLITIKË

["Kecin do e pjekim dhe nëse s'e bën", Sara Mile i premton të moshuarit urën: Do ta bëjmë për respekt të ditëlindjes](#)

19 Shtator 2026, 10:35

^ekstrakti^



POLITIKË

["Prania besnike", socialistët listojnë qindra ankesa, Rama: S'është ideja të marrim e të çojmë halle](#)

19 Shtator 2026, 08:39

^ekstrakti^



POLITIKË

[Socialistët në fushatë me të njëjtën "kartë", Erion Braçe: Po fitova, do të bëj legalizimet!](#)

18 Shtator 2026, 22:32

^ekstrakti^



POLITIKË

[Udhëheqës i grupit parlamentar të Kuvendit, Dritan Hoxha: Një nga shprehjet e demokracisë është](#)

[U murratua nga mazmoria e re e xhuvit, dega e sekrecionit ngjitet për pagat e magjikutave](#)

18 Shtator 2026, 19:30

^ekstrakti^



POLITIKË

[Rama paralajmëron pronarët e supermarketeve: Ulini çmimet ose do të thoni "ç'na u desh fitimi"!](#)

18 Shtator 2026, 17:03

^ekstrakti^



POLITIKË

[Lirohet nga detyra Altin Jani! Ja kush është drejtuesi i ri i Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar](#)

18 Shtator 2026, 15:17

^ekstrakti^



POLITIKË

[Diskutimet për ligjin e ri të pagave, Rama fton KLGJ e KLP: Mos e harroni se pagat më të larta, erdhën nga vula e PS](#)

18 Shtator 2026, 11:37

^ekstrakti^

[Të fundit](#)





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.